



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 50

Prishtinë, më 26.01.2016, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Doruntinë Maloku, Agim Ademaj dhe Milena Miliçević.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Avni Uka- Bota Sot; Gresë Sermaxhaj – Kosova Sot; Agon Gashi-PILPG; Petrit Hysaj-OSBE; Dren Ajeti-GSJP; Amire Qamili-BIRN; Gentiana Azemi-Praktikë; dhe Gentiana Kadrija– KosovaPress.

Mbledhjen e kryesoi, Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2016;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i grupit punues në Projektligjin nr.05/L-60 për Mjekësinë Ligjore;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2016

Kryesuesja- Në fjalën e saj hyrëse tha se në Kuvend ka ardhur Strategjia Legjislative nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Zyra për mbështetje të Komisionit në konsultim edhe me mua kemi përgatitur një draft-plan për vitin 2016, i cili është para jush ku është shpërndarë më herët në kutitë postare të deputetëve. Paraprakisht po ju tregoj se në këtë draft-plan nuk janë përfshirë Rregullorja e Punës së Kuvendit, e cila ka mbetur pa aprovim në vitin e kaluar, Projektligji për Kuvendin, Projektligji për Agjencinë Kosovare për Verifikim dhe Krahësim të Pronave. Po ashtu nuk janë të parapara dëgjimet publike, ku mendoj se duhet të diskutojmë si komision se çfarë mendojmë, për çfarë projektligjesh do të mbajmë dëgjime publike, apo do të mbajmë për të gjitha projektligjet të cilat i kemi për shqyrtim. Dhe kemi menduar që të monitorohen dy ligje që janë në fuqi nga komisioni për legjislacion, njëri në sesionin pranveror dhe tjetri në sesionin vjeshtor. Propozimet të dalin nga komisioni meqenëse nuk kemi ndonjë kërkesë nga asnjë institucion organizatë joqeveritare që kanë vërejtur ndonjë shqetësim që mund të na sugjerojë se cili ligj do të jetë më i dobishëm të monitorohet. Si propozim janë dy ligje, por nëse ka propozime tjera për monitorim të ligjeve, ne mund të shkojmë edhe më shumë se dy. Kryesuesja hapi debatin për diskutim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Armend Zemaj- Në fjalën e tij tha se Plani i Punës do të jetë një para prirje e punës tonë për vitin 2016. Unë mendoj që ne të fokusohemi më shumë në mbikëqyrje dhe në përcjellje të implementimit të legjislacionit, qoftë atë që e kemi kaluar, por qoftë edhe atë që është në interes të përgjithshëm apo disa që ka dalë si kërkesë e jona dhe e shoqërisë civile. Ne e kemi marrë Strategjinë Legjislative nga fushat që bien ligje në fushëveprimin e komisionit. E kam parë që është pak e ngarkuar dhe do të jetë i ngarkuar edhe ky vit dhe për këtë arsye plani i punës, hartimi i një dinamike të qartë mendoj se edhe neve do të na lehtësoj t'i mbërrijmë objektivat tona krahas edhe zhvillime të tjera, sepse nuk janë vetëm këto që kufizohen brenda komisionit për legjislacion. Besoj që plani i punës duhet të plotësohet me tri pika që i përmendet: ligji për Kuvendin, në kuadër të tij është edhe ligji për të drejtat dhe përgjegjësit e deputetit, por edhe hartimi i rregullores së re. Nënkomisioni ka vendosur që të punojë mbi dokumentet bazë që janë produkt i joni, është produkt i një pune që është bërë edhe më herët dhe e kemi më lehtë. Sa i përket ligjit për Verifikim dhe Krahësimin të Pronës është në vazhdimësi dhe është pjesë e kësaj. Ne mendojmë që do të kryhet në harmoni me kohën dhe planin e punës që e kemi përcaktuar. Komisioni për legjislacion, vitin e kaluar, ka qenë shumë i fokusuar në reformën në drejtësi dhe besoj që nuk do të ishte e stërngarkuar që ne të vazhdojmë, por tani të kalojmë në fazë tjetër të implementimit të këtij legjislacioni. Është trumbetuar shumë që kemi bërë një hap të madh dhe unë qëndroj prapa asaj që është bërë një hap i madh dhe për këtë arsye propozoj që dy ligje, Ligji për Këshillin Prokurorial dhe Ligjin për Këshillin Gjyqësor të jenë pjesë e monitorimit, sepse është krijimi i trupave të reja dhe ndryshimet kushtetuese që janë bërë dhe janë propozuar që të bëhen. Mendoj që këtu duhet ta kemi edhe një sugjerim profesional, sepse janë pushtete të ndara dhe mos të shihet si përzierje në fushën apo në elementet që prekin sistemin e drejtësisë. Komisionit duhet t'i interesojë se ndryshimi i këtyre ligjeve sa ka qenë produktiv dhe a është produktiv në luftimin e dukurive negative dhe avancimin e sistemit gjyqësor në vend? Po ashtu monitorimi i ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale që ka të bëjë me rregullatorin e burgjeve në Republikën e Kosovës, apo edhe ligjet tjera, si Ligji për të Miturit dhe pjesa tjetër që ka hyrë me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale. Këtu, unë mendoj nëse mund t'i përkufizojmë gjatë vitit t'i ndajmë pjesa e parë dhe pjesa e dytë. Unë e shoh se ndoshta janë synime ambicioze sepse edhe Strategjia Legjislative është e ngarkuar, sepse Komisioni ka edhe punë të tjera për të bërë por me ndihmën edhe të OSBE-së, shoqërisë civile dhe partnerëve të tjerë që e mbështesin Kuvendin mendoj që kemi mundësi t'ia arrijmë. E përkrah si plan të punës

këtë dokument që e keni paraqitur ju dhe plotësimet që do të dalin, por asnjëherë mos të kufizohemi, por çdo herë mundet dhe të rishikohet me propozime shtesë që dalin, qoftë nga mbikëqyrja dhe qoftë nga hartimi i legjislacionit të ri.

Kryesuesja- Në fjalën e saj të sërishme tha, se është fakt se organet e drejtësisë janë të ndara, mirëpo në aspektin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjshmërisë është punë e Kuvendit që të bëjë një monitorim të tillë. Doja t'ju pyesja, a keni menduar që këto dy ligje për Këshillin Prokurorial dhe për Këshillin Gjyqësor të bëhen të dyja në Sesionin Pranveror për të parë se si kanë reflektuar ndryshimet apo keni menduar të jenë të ndara sepse u përmendën një varg ligjesh që ju mendoni të monitorohen? Unë e përkrahë si iniciativë dhe të fusim në agjendë monitorim e këtyre dy ligjeve dhe mendoj që dyja të shkojnë në pako. Ajo se çfarë ne mund të bëjmë është të kemi takim me kryesues të shohim se si po ecën implementimi i këtyre ligjeve dhe cilat janë rezultatet e pritshme nga ndryshimet që janë bërë vitin e kaluar. Besoj se me dy takime ne mund të vijmë në një përfundim sepse edhe të lëshohemi më tepër në monitorimin e këtyre ligjeve në takime dhe me mekanizma të tjerë domosdoshmërisht do të na merret si lloj ndikimi. Të dyja të mbesin në sesionin vjeshtor dhe të shkojmë në një monitorim në pako për të dyja. Doja të ju pyesja Armend çështjen e Rregullores së Punës së Kuvendit dhe projektligjin për Kuvendin, a e keni menduar se kur mund të përfundojë?

Armend Zemaj theksoi se tre mujorin e parë përfundojnë d.m.th. muajin mars duhet të jenë të përfunduara.

Kryesuesja- Sa i përket Projektligjit për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës nga viti i kaluar dhe për Projektligjin për administrim e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar unë e kisha të njëjtin rast edhe me Projektligjin për Mjekësinë Ligjore të cilin e kemi përfunduar dhe e kemi lënë në afatin e janarit. Gjatë muajit janar pritet që të miratohen amendamentet në komision.

Agim Ademaj- Në fjalë e tij tha se Projektligji për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar grupi punues punën e tij e ka përfunduar dhe është e gatshme për të hyrë në planin e punës të muajit shkurt.

Kryesuesja- Në fjalën e saj të sërishme tha se për Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, pavarësisht ndjeshmërisë ne e kemi me rregullore që të kërkohet një muaj plus kohë shtesë.

Armend Zemaj- Në fjalën e tij tha se kemi kërkuar kohën shtesë dhe na është lejuar nga Kryesia e Kuvendit dhe ka kohë d.m.th. nuk jemi keq me kohë. Në pjesën e parë të sesionit pranveror kemi paraparë që të jetë.

Agim Aliu- Në fjalën e tij tha se është mirë që ka ardhur Strategjia Legjislative sepse edhe ne nuk kishim pasur mundësi për të miratuar në fakt një plan të punës. Unë dakordohem me z. Zemaj që edhe ne të bëjmë një lloj ekuivalence, jo vetëm të miratojmë ligje sepse është një konstatim edhe më i mëhershëm që jemi dakorduar shumica prej anëtarëve, jo vetëm si komision, po edhe në Parlamentin e Republikës së Kosovës edhe shoqëria civile që më shumë kemi ngecje të implemetimit të ligjeve. Prandaj do të duhej të fokusoheshim më shumë në këtë pikë. Po të njëjtat çështje ne edhe paraprakisht i diskutuam dhe absolutisht dakordohem që ne të shtojmë fokusin e ligjeve që të bëjmë një monitorim të përkryer dhe sigurisht në mënyrë të

veçantë edhe për ligjet për KPK-në dhe KGJK-në, por të mbeten në sesionin vjeshtor për faktin se ne mund të na ndryshojë agenda legjislative për arsye se do të ketë edhe ndryshime kushtetuese pikërisht sa i përket çështjes së ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe ne nuk do të mund të kemi në plan të punës strategjinë legjislative në sesionin pranveror, sepse veç do të merremi edhe një herë me një ligj të tillë. Pas miratimit në pjesën e parë të vitit ne mund ta fusim si pjesë e monitorimit në sesionin vjeshtor. Lidhur me çështjes që u ngritën të rëndësishme së pronës, është veç pjesë e agjendës dhe është mirë që është në pjesën e majit. Është një projektligj që ka kaluar gjatë, por më shumë se sa ky projektligj unë shqetësimin e kam te një projektligj krejt tjetër më shumë te jo serioziteti i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe ndoshta do Zoti është fundi i një strategjie legjislative çështja e projektligjit të konfliktit të interesit dhe ushtrimin e funksionit publik. Unë mendoj se Qeveria ka treguar jo seriozitet në të dyja rastet edhe me draftin, por edhe me tërheqjen. Mendoj se ka vënë në pozitë jo të mirë edhe vetë Komisionin për Legjislacion dhe vetë grupet punuese të cilat kanë punuar edhe herën e parë edhe herën e dytë me këtë projektligj, pavarësisht që ne kemi adresuar vërejtjet e caktuara. Ne kemi menduar dhe kemi besuar që të kemi një projektligj më të mirë, por ajo ka qenë mundësia që ne kemi draftuar një version të tillë dhe për arsye të pasqaruara deri në fund në të dyja herët Qeveria e Republikës së Kosovës në momentin e fundit e ka tërhequr projektligjin. Unë kam dilemën që vërtet të jetë pjesë e agjendës legjislative nga ana Qeverisë apo të jetë nga ana e Komisionit?! Qeveria vërtet ka treguar një jo seriozitet në këtë projektligj të pasqaruara nga ana e tyre, ashtu si edhe e përmenda më parë. Unë mendoj që kjo çështje duhet diskutuar, por mund ta lëmë edhe kështu. Jam i tharë se ne, si komision, kemi diskutuar edhe me shoqërinë civile që të jetë një nismë nga ana e komisionit që praktikisht ky projektligj të miratohet. Duke parë edhe rëndësinë e tij dhe po ashtu duke parë edhe vërejtjet që janë dhënë, jo vetëm nga shoqëria civile, por edhe nga mekanizmat ndërkombëtar, pasi që bënë pjesë në kuadër të ligjeve të rëndësishme në luftimin e krimit të organizuar dhe të korrupsionit. Unë mendoj se do duhej të ishte hera e fundit që ne e shohim si pjesë të agjendës legjislative. O do duhet të kemi sigurinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës se a është serioze të bëjë një projektligj të mirë të Konfliktit të Interesit, o duhet të kemi sigurinë se ne e dërgojmë vetë si Komision për Legjislacion. Po ashtu është një vonesë në çështjen e rregullores së ligjit, që u konstatua por mirë që mbet në tremujorin e parë të diskutohet sepse ne po kalojmë në vitin e dytë të legjislacionit të pestë (V) dhe ende nuk e kemi rregulloren e punës, por pak a shumë i kemi arsyet e ditura sepse ky Legjislacion ka pasur shumë pamundësi në çështjet që do duhej të ishin pjesë e një agjende normale dhe pak a shumë është normale vonesa për një rregullore apo për një ligj të caktuar.

Agim Ademaj- Në fjalën e tij tha se është plan i mirë i punuar dhe le të plotësohet nga ato që u dha prej kolegëve. Sa i përket projektligji për konfliktin e interesit, e tha Agimi Aliu se si komision kemi punuar dy herë në këtë projektligj. Ai ka qenë projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të mëparshëm. Është premtuar që do të punohet një projektligj komplet i ri nga ana e Qeverisë dhe atëherë do të vijë në Komision. Është e vërtetë që kemi pasur shumë probleme me këtë projektligj, por nëse punohet një projektligj i ri atëherë të shohim se çfarë po na vjen. Nëse na vjen një projektligj i ri, ashtu si e ka paraparë Qeveria, komisioni do të punojë në atë projektligj dhe mos të jetë iniciativë e jona.

Kryesuesja- Tha se kemi edhe një çështje që duhet ta parashohim në plan të punës për vitin 2016, që Komisioni për Legjislacion duhet ta mbajë një takim me institucionet të cilat bien në fushëveprimin e komisionit tonë për të shqyrtuar çështjet buxhetore të këtyre institucioneve. Kemi menduar që këtë takim ta bëjmë në muajin prill, kur edhe fillon angazhimi i këtyre institucioneve dhe puna e Qeverisë në përgatitjen e rishikimit të buxhetit të vitit 2016. Kurse për

një takim për vitin 2017 për çështjet buxhetore ta mbajmë më vonë dhe e caktojmë më vonë. Mirëpo si takime ta mbajmë në muajin prill sepse Qeveria fillon që t'i konsultojë edhe zërat buxhetorë dhe fillon që të përgatisë pakon e rishikimit buxhetor për në mes të vitit. Nga viti i kaluar na ka mbetur ligji për deklarimin e pasurisë. Ka qenë i paraparë si ligj që duhet të monitorohet dhe nëse ju jeni dakord ne e kishim futur në vitin 2016 që gjatë sesionit pranveror të monitorojmë ligjin për Deklarimin e Pasurisë. Muajin tjetër mund ta formojmë grupin punues për monitorimin e këtij ligji dhe pas punës që do ta kryej i raporton komisionit. E kam edhe një propozim, meqenëse nuk është ligj shumë voluminoz, por vitin e kaluar ka pësuar plotësim-ndryshime dhe ligji për provimin e Jurisprudencës është prapë në strategji. Të bëjmë një monitorim rreth kërkesave që janë bërë Ministrisë Drejtësisë dhe mekanizmave të tjerë, kur kemi bërë monitorimin e ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe të shohim se a i kanë përmbushur ato rekomandime që kanë dalë nga monitorimi i ligjit nga ana e komisionit. Kjo mund të bëhet në sesionin pranveror.

Agim Ademaj- Tha se edhe pse ligjet janë në procedurë për ndryshim plotësim nuk do të thotë që nuk kemi të drejtë t'i monitorojmë, sepse ligjet ekzistuese janë dhe më shumë mund të na ndihmojnë t'i shohim pengesat dhe në plotësim të tyre mund t'i shohim më lehtë. Nuk është dashur të jetë pengese ligjit që janë në procedurë për t'i monitoruar.

Kryesuesja- Në fjalë e saj të sërishme tha se po monitorojmë ligjin e Provimit të Jurisprudencës që ishte si propozim i imi dhe me një takim ne mund ta dimë se a i ka plotësuar Ministria e Drejtësisë rekomandimet që kanë dalë nga monitorimi i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, apo ku ka mbetur zbatimi i këtyre rekomandimeve. Gjithashtu ne kemi edhe projektligje që përafërsisht na kanë mbetur përgjysmë duke përjashtuar dy që kanë përfunduar dhe pritët amendamentet të miratohen në komision. Mendoj që për secilin projektligj dhe i takon strategjisë legislative 2016 dhe i takojnë komisionit tonë, si Komision Funkcional, për të gjitha të organizojmë dëgjime publike. Pas leximit të parë në Kuvend të organizohen dëgjime publike me aktorë të ndryshëm apo të fushave të interesit dhe më pastaj pas dëgjimit publik grupi punues të fillojë të marrë shqetësimet, komentet nga mekanizmat e ndryshëm apo palët e atakuar me projektligj. Ta bëjmë një plan të punës për secilin projektligj sepse është shumë vështirë. Ne kemi provuar edhe vitin e kaluar, kur kemi punuar në grupet punuese amendamentet, pastaj edhe në komision janë shqyrtuar së bashku me të gjitha aktorët të cilët kanë dhënë kontributin e tyre dhe ju i dini rastet që na kanë ndodhur lëshime jo me qëllim, por për shkak të ngarkesave, kërkesave të diskutimeve të shumta. Pas leximit të parë të secilit projektligj grupi punues apo komisioni të jetë i obliguar të mbajë dëgjim publik për secilin projektligj që e kemi në fushën tonë për këtë vit.

Milena Miliçević- Në fjalën e saj tha të përsëritet procedura sa i përket projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të pronës, sepse e vlerësoj se janë disa çështje që i prekin interesat e komuniteteve. Shumica e rasteve kanë të bëjnë me ato prona. Unë e di që puna e grupit punues ka përfunduar, por mendoj që prapë do të kemi mundësi që t'i ftojme disa persona nga Ministria e për Komunitete dhe Kthim të cilët do të japin mendimin e tyre për këtë projektligj.

Kryesuesja- Sqaroi se për projektligjin për të cilin ju po flisni është i paraparë për vitin 2016 dhe grupi punues ende nuk ka përfunduar. Parashihet diku nga muaji maj në draft-planin e

punës që të përfundojë kështu që ju jeni anëtare e këtij grupi punues dhe nuk do të mbahet asnjë takim pa ju informuar edhe juve.

Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Plani i Punës për vitin 2016 me ndryshimet e propozuara.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i grupit punues në Projektligjin nr. 05/L-60 për Mjekësinë Ligjore

Kryesuesja – Në fjalën e saj tha se meqenëse kam kryesuar këtë grup punues për amendamentin e projektligjit për Mjekësinë Ligjore po e arsyetoj para jush. Nga viti i kaluar na kanë mbetur dhe dy apo tri çështje për të cilat kemi menduar se duhet edhe një takim. Dje kemi pasur edhe takimin e fundit të grupit punues dhe e kemi përfunduar amendamentin e këtij projektligji.

Milena Miliçević- Në fjalën e saj tha se e kam një vërejtje teknike në amendamentin nr. 6 . Inicialet e ADN-së në gjuhë serbe mendoj se duhet të jetë DNK.

Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

P e r f u n d i m

- I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit;
- II. Projektligji për Mjekësinë Ligjore nr. 05/L-60 dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet kryesore;
- III. Amendamentet e miratuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

4. Të ndryshme

Komisioni vendosi që mbledhja e radhës të jetë më 2.02.2016, në orën 11:00, nëse nuk ka ndryshime në agjendën e Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi

Aneks- Amendamentet e miratuara për Projektligjin nr. 05/L-060 të Mjekësisë Ligjore

Amendamenti 1

Në Nenin 1 të projektligjit, në rreshtin e tretë, fjala “Agjencisë”, **hiqet** dhe zëvendësohet me “Instituti” dhe në tërë tekstin e projektligjit fjala “Agjencisë/Agjencia”, **hiqet** dhe zëvendësohet me “Instituti/Instituti”, në varësi të kontekstit të fjalisë.

Amendamenti 2

Në nenin 6, nënparagrafi 1.3, hiqen fjalët: “*në çështjen e atësisë dhe amësisë biologjike*” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 3

Në nenin 15 të projektligjit, nënparagrafi 1.5, **hiqet** dhe renditja e nënparagrafëve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 4

Në nenin 15 të projektligjit, nënparagrafi 1.6 riformulohet si vijon: “1.6. Kërkimi, gjetja dhe zhvarrimi, si dhe përcaktimi i fatit, identifikimi dhe dorëzimi i mbetjeve mortore të personave të pagjetur që ndërliken me luftën në Kosovë”.

Amendamenti 5

Në nenin 15, pas nënparagrafit 1.6, shtohet nënparagrafi ri si vijon: “1.7. Mbajtja e kontaktit me familjet e personave të pagjetur dhe bashkëpunimi me organizatat dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare, që janë të përfshira në procesin e zbardhjes së fatit të personave të pagjetur”.

Amendamenti 6

Në nenin 15, pas paragrafit 1, shtohen paragrafët 2 dhe 3, me tekstin vijon:

”2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, në rastet kur ekzaminimi i caktuar mjekoligjor, duke përfshirë ekzaminimin e profilit gjenetik të ADN-së, i tejkalon kapacitetet e Institutit, këto ekzaminime, me urdhër të Prokurorit të Shtetit apo Gjykatës, bëhen në institucione tjera në pajtim me ligjin”.

3. Instituti i Mjekësisë Ligjore harton një raport vjetor që përshkruan punën e tij, duke përfshirë, mes tjerash, numrin e ekzaminimeve të realizuara dhe të dhëna të tjera përkatëse, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe atë më së largu deri në muajin mars”.

Amendamenti 7

Titulli i nenit 18 i projektligjit, riformulohet: “**Dispozitat kalimtare**”.

Amendamenti 8

Në nenin 18, pas paragrafit 4, shtohen paragrafët 5,6 dhe 7, me tekstin si vijon:

5. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të punësuarit në Departamentin e Mjekësisë Ligjore, vazhdojnë të punojnë në Institutin e Mjekësisë Ligjore, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Instituti është trashëgues juridik i Departamentit të Mjekësisë Ligjore me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

7. Termi “Departamenti i Mjekësisë Ligjore”, i përmendur në cilindo ligj apo akt nënligjor në fuqi, zëvendësohet me termin “Instituti i Mjekësisë Ligjore”.

Amendamenti 9

Në nenin 18 të projektligjit, fjala “EULEX-it”, hiqet dhe zëvendësohet me “EULEX KOSOVA” dhe në tërë tekstin e projektligjit kur përdoret kjo fjalë sipas trajtës: “EULEX-it, EULEX apo EULEX-i”, hiqen dhe zëvendësohen me “EULEX KOSOVA”.